



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 506/1 prot.

Tiranë më 13.5.2020

Lënda: Mendim mbi një projektvendim

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE E EKONOMISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 7536/1 prot., datë 05.05.2020, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”, i cili është hartuar në zbatim të nenit 18, të ligjit nr. 4/2020 “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”, Zyra e Komisionerit vlerëson përfshirjen e sugjerimeve të mëposhtme.

Pas pikës 1 të nenit 12 të projektvendimit, të shtohen dy pika me këtë përmbajtje:

“2. Shkëmbimi i informacionit mbi llogaritë e raportueshme duhet të realizohet duke respektuar parimin e mjaftueshmerisë, proporcionalitetit dhe afatit të përpunimit të të dhënave në përputhje me legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale.

3. Gjatë procesit të shkëmbimit të informacionit mbi llogaritë e raportueshme duhet të garantohen masat e sigurisë së të dhënave personale, evidentimi i gjurmimit të përpunimit të të dhënave personale, dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave/tatimpaguesve.”

Përfshirja e sugjerimeve të mësipërme në projektvendim, e sjell atë në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

